



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Sh.II.nr.319/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbare të kreditorit Kompania Regjionale e Mbeturinave Uniteti sh.a nga Mitrovica kundër debitorit A.Gj.DPT ... adresa rruga ... nga Vushtria, në procedurën e përmbaremit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri, CPP.nr.431/20 i datës 25.01.2021, jashtë seancës me datën 24.08.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit A.Gj.DPT ..., adresa: rruga ... nga Vushtria, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri, CPP.nr.431/20 datës 25.01.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin e ankimuar CPP.nr.431/20 i datës 25.01.2021, e ka hedhur propësimin e debitorit DPT ... A.Gj.nga Vushtria, të ushtruar kundër urdhrit përmbaremit P.nr.573/20 të datës 19.02.2020, me të cilin përmbaremit privat Atip Mustafa nga Vushtria, duke vepruar sipas propozimit për përmbaremit të kreditorit me datë 19.02.2020, ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbaremitin në bazë të dokumentit të besueshëm - faturave në emër të pagesës së borxhit në shumë prej 1,228.13, për kryerjen e shërbimeve komunale të bartjes së mbeturinave, të cilat sipas nenit 21 dhe 29 të LPK-së, paraqet dokument të besueshëm dhe është i përshtatshëm për përmbaremit.

Kundër këtij aktvendimi ka parashtruar ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale. Gjykata e shkallës së parë në mënyrë jo të drejtë ka zbatuar dispozitën e nenit 7 dhe 8 të LPK-së ngase ekstraktet e paraqitura nga ana e kreditorit nuk janë të qarta dhe nuk paraqesin kronologjinë e borgjit, as nuk specifikohet se për cilët muaj është bërë pagesa, dhe kur është ndërprerë parashkrimi. Borxhi për shërbimin e ujit është borxh periodik andaj edhe faturimi i tij duhet të jetë në fund të qdo muaji. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë gabimisht e ka vërtetuar si fakt vendimtar ekstraktin e shpenzimeve të kreditorit duke e tejkualuar edhe kërkesën kreditorit dhe atë pa llogaritur fare shpenzimet për periudhën e lartcekur e ka detyruar debitorin të paguaj shpenzimet për të cilat ende nuk ka arritur kërkesa. Gjykata e shkallës së parë nuk e ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitën e nenit 360 par.1 nenp.1.1 dhe par.2 i LMD. Propozon që të aprovohet ankesa e debitorit, ndërsa aktvendimi i atakuar të priset dhe qështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje, apo ta ndryshoj aktvendimin e atakuar.

Përgjigje në ankesë nuk gjendet në shkresat e lëndës

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj *debitorit* në bazë të dokumentit të besueshëm faturave për shërbimet e kryera komunale të bartjes së mbeturinave në shumë prej 1,228.13€. Përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin me urdhrin P.nr.573/20 të datës 19.02.2020, ndaj të cilit urdhër debitori ka paraqitur prapësim me datën 06.03.2020.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimit, jashtë seance ka nxjerrë aktvendimin e atakuar, CPP.nr.431/20 i datës 25.01.2021, me të cilin e ka hedhur poshtë si të pa afatshme prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit ka theksuar se prapësimi i parashtruar është i pas afatshëm pasi që urdhrin për lejimin e përmbartimit me nr. P.nr.573/2020 dt. 19.02.2020, në bazë të fletë kthesës që gjendet në shkresa të lëndës, debitori e ka pranuar me dt. 25.02.2020, në të cilin urdhër i është dhënë këshilla juridike se ndaj tij mundë të ushtroi prapsim në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit, ndërsa debitori prapësimin kundër urdhrin për përmbartim e ka ushtuar me dt.06.03.2020, çka do të thotë 10 ditë jashtë afatit ligjor, andaj duke u gjendur pranë një situatë të tillë gjykata në kuptim të nenit 73 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore (LPP), vendosi që prapësimin e debitorit ta hedhë poshtë si të pa afatshme.

Dhoma e Shkallës së Dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g),( j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm sepse në rastet kur paraqitja e prapësimit lidhet me afat, gjykata është e detyruar që fillimisht ta vlerësojë afatshmërin e prapësimit. Në çdo rast pas shqyrtimit paraprak të prapësimit kur gjykata gjen se prapësimi është paraqitur pas skadimit të afatit i njëjti duhet të hedhet poshtë. Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vepruar kur ka hedhur poshtë si të pasafatshëm prapësimin e debitorit të ushtuar ndaj urdhrin mbi lejimin e përmbartimit P.nr.573/20 të datës 19.02.2021. Në bazë të nenit 70 të LPP-së, përcaktohet se: *“Prapësimi duhet t'i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbartues ose urdhrin përmbartues”, në rastin konkret*

*debitorit prapësimin e ka paraqitur pas kalimit të afatit 7 ditor*”. Në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës vërtetohet fakti se debitori urdhrin mbi lejimin e përmbarimit e ka pranuar me datën 25.02.2020, ndërsa prapësimin ndaj këtij urdhri e ka paraqitur me datën 06.03.2020. Nga kjo rezulton se prapësimi është paraqitur pas afatit ligjor, pra më shumë se 7 ditë.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se debitori në pretendimet ankimore fare nuk ka kontestuar afatshmërinë e prapësimit me të cilin është kundërshtuar urdhëri për lejimin e përmbarimit P.nr.573/20 dt.19.02.2020 i përmbaruesit privat Atip Mustafa nga Vushtria, e që në rastin konkret është fakti vendimtar në të cilin është bazuar gjykata e shkallës së parë. Ndërsa pretendimet tjera ankimore gjykata i konsideroi pa ndikim në një vendosje tjetër nga ajo që ka vendosur gjykata e shkallës së parë. Andaj, duke pasur parasysh të lartcekurat, kjo gjykatë vlerësoj se duhet refuzuar si të pathemeltë ankesën e debitorit dhe vërtetoj aktvendimin e atakuar.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË  
Dhoma e Shkallës së Dytë  
Kom.Dh.Shk.II nr.319/22 datë 24.08.2022

Gjyqtari  
Krenar Berisha